



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 448 Prot.

Tiranë, më 28.03 2019

VENDIM Nr. 74 datë 18.03.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, datë 18.03.2019, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Handrianopolis" 2019*, drejtuar nga Prof.Dr. Dhimitër Condi (IA) dhe Prof. Dr. Roberta Perna (Univ.Maceratës-Itali), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Handrianopolis" 2019*, drejtuar nga Prof.Dr. Dhimitër Condi (IA) dhe Prof. Dr. Roberta Perna (Univ.Maceratës-Itali), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

Vazhdimi i gërmimeve arkeologjike në:

- Sipërfaqen përballë teatrit ku janë identifikuar ndërtesa kryesore publike, Banjo, Ndërtesë monumentale dhe Tempulli si dhe shtrirjen e zonës së gërmimit në anën perëndimore deri përball zonës së Teatrit.
- Gërmimi në Melan i cili do të japë një stratigrafi kronologjike të jetës së qytetit dhe të mureve fortifikues të periudhës Helenistike dhe Bizantine.

Restaurimi arkeologjik

- Punimet e restaurimit në mure do të kryhen me referencën dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm të Institutit të Monumenteve të Kulturës në Tiranë dhe zyrave të saj periferike të Gjirokastrës. Vëmendje e veçantë do të vendoset si zakonisht në restaurimin dhe konsolidimin e strukturave që do të dalin në dritë gjatë gërmimeve të reja dhe mirëmbajtjes së atyre që janë ndërtuar që nga viti 2011.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
 3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.

4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARIT
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**